

Kontaktverbot für Dortmund / Lünen

Handzettel Albanisch

Masat tjera kundër koronavirusit

Qeveria e Landit ka lëshuar një urdhëresë lidhur me ndalimin e gjerë të kontakteve për Landin Nordrhein-Westfalen më 22.03.2020. Kjo vlen menjëherë për hapësirën kohore deri më 19 prill.

Ndalesa e gjerë e kontakteve

- Takimet dhe tubimet prej më shumë se dy personave janë të ndaluar në publik.
- Përrjashtim: Familjarët e linies së drejtë, bashkëshortët, partnerët bashkëjetues si dhe personat që jetojnë në një bashkësi.
- Shoqërimi i personave të mitur dhe që kanë nevojë është i lejuar.
- Takimet e detyruara për shkaqe biznesore, profesionale dhe shërbyese si dhe për arsye të provimeve ose përkujdesjeve të rëndësishme janë të lejuara.
- Shfrytëzimi i qarkullimit në trafik me mjete publike është i lejuar.



Dënimet në rast të moszbatimit të ndalimit të kontaktit

- Zyret përgjegjëse (enti për rregull, policia) janë të detyruara të zbatojnë këto rregulla në mënyrë konsekuente, nëse është nevoja, edhe me mjete të detyruara.
- Kundërvajtjet dënohen me një shumë prej së paku 200 euro deri më 25 000 euro dhe veprimet kundërligjore me heqje lirie deri në 5 vite.

Gastronomi

- Veprimtaritë e restoranteve, rostiçerive (çebaptoreve, fastfood), menzave, kantinave (jo kantinave të fabrikave) dhe institucioneve tjera gastronomike janë të ndaluara.
- Shpërndarja e ushqimeve dhe pijeve si dhe shitja jashtë objektit është e lejuar, nëse mbahet distanca për mbrojtjen nga infeksionet. Konsumimi i ushqimit në një rreth prej 50 metrash nga institucioni gastronomik është i ndaluar.
- Kantinat e fabrikave, që nuk janë të hapura për publik, por shërbejnë për të punësuarit, mund të veprojnë, nëse i plotësojnë kushtet rigoroze.